

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“AS TEKNOLOJIK ALBANIA” SH.P.K.

Themeluesi qe nenshkruan me poshte eshte si vijon:

Z. AHMET SAHIN, i datelindjes 24.07.1968, i birii Rusan, lindur ne Stanboll, Turqi dhe banues ne Levazim Mah. Kardelen Sk.No: 10A/7 Besiktas, Stamboll, shtetas turk mbajtes i pasaportes nr.U13197764 dhe nr personal turk 44758376734 madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Qe ne vijim do te quhet Ortaku i Shoqerise “AS TEKNOLOJIK ALBANIA” SH.P.K.

Sot me date **01.02.2021**, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosi te themeloje Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I
OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i shoqerise

Shoqeria Tregtare “AS TEKNOLOJIK ALBANIA” SH.P.K, ka si objekt veprimtarie:

1. Projektim, ndertim dhe mirmbajtje e ndertesave per interes publik. Ndertim banesash, qendra industriale, vepra arti, infrakstruktura, rruge. Piste, hambare, kulle vrojtimi dhe ambjente akomoduese per aeroporte. Port detar, qendra biznesi, fshat turistik. Ndertimi i banesave me qendrushmeri te larte sizmike.
2. Sherbime Konsulence per tregti nderkombetare, import – eksport te cdo lloj produkti, malli apo sherbimi.
3. Studim, Kerkim, Nxjerrje, Perpunim dhe Tregtimi me shumice i produkteve te nentokes, te ngurta, te lengta dhe te gazta.
4. Mund te hyje ne tratativa dhe biznese me shoqeri te tjera qe kane te njejtin objekt veprimtarie per te realizuar fitime ne fushat e permendura me lart. Marrja pjese neper ankande dhe tendera, si dhe te beje sherbime qe kane lidhje me objektin e veprimtarise se saj. Pregatitja e projekte investuese dhe trajnime fizibilituese, si dhe t’i menaxhoje ato.
5. Shoqeria, sic mund te ushtroje punet qe tregohen ne objektin e veprimtarise se saj, brenda dhe jashte vendit, ashtu edhe mund te marre pjese, te perfitoje apo te transferoje nga/te palet e tjera, mund te marre pjese ne kapitalet e personave juridike dhe fizike, te vendit apo te huaj, te krijuar ose qe krijohen me qellim tregtie, industrie, etj., ne lidhje me keto fusha. Te Perfitoje, transferoje, te marre apo jape me qera, te bleje dhe shese, si dhe te kontraktoje, te drejten e markes, patentes, licences, dhe te drejttat e tjera qe jane te ngjashme me keto

Neni 2

Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

Ortaket vendosen qe shoqerine ta emertojne “AS TEKNOLOJIK ALBANIA” SH.P.K.

Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne Rruga Kavajes, Pallati 01, Hyrja 09, kati 03, Ap. 3 Tirane, Shqiperi



Shoqeria mund te krijoje qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjenci ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni 3

Forma Juridike

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te ORTAKEVE mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijoje pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjetere ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar eshte **100.000 (njqind mije) Leke**. 1 (nje) kuote gjithsej.

Ortaket e shoqerise jane:

1. **AHMET SAHIN**, zotërues i 1(nje) kuote me vlere 100.000 leke, qe perfaqeson **100% (njqind %)** kapitalin themeltar të shoqërisë;

Kreu IV

PERSONALITETI JURIDIK

Neni 7



Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar në Qendren Kombëtare të Biznesit në Tiranë, si dhe fillon veprimtarinë e saj me marrjen e licencës të ushtrimit të veprimtarisë.

Kreu V ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqeria do të administrohet nga administratori **AHMET SAHIN** i cili përfaqëson shoqerinë në marrëdhëniet me të tretet për një periudhë **5 (pese)** vjetëre dhe me të drejtë rizgjedhje.

Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.

Kreu VI DISPOZITA TË TJERA

Neni 9

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes së detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut të saj, ta ndajë si dividend apo ta shtojë në kapitalin e shoqerisë.

Ky Akt shtypet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të shoqerisë.

ORTAKU THEMELUES

AHMET SAHIN

Përfaqësuar me Prokurë

ERGYS DERVISHI

